



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**KGJK. Nr. 83/2020**  
**Datë: 08 maj 2020**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe pas vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës të datës 03 maj 2020, me datë 08 maj 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. Shtohet aktiviteti i punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe i të gjitha Gjykatave të vendit.
- II. Kryetarët e Gjykatave të caktojnë gjyqtarët dhe stafin administrativ të nevojshëm për të realizuar veprimtaritë gjyqësore si dhe për të kujdestaruar për rastet e natyrës urgjente, të caktimit të masave për sigurimin e prezencës së të pandehurve – paraburgimit apo masave tjera, rastet e dhunës në familje, masave tjera, si dhe rasteve tjera urgjente që eventualisht mund të paraqiten.
- III. Në këtë fazë gjyqtarët do të trajtojnë edhe rastet tek të cilët nuk është e nevojshme pjesëmarrja e palëve dhe publikut në procedurë.
- IV. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të organizoj punën e Sekretariatit duke angazhuar sipas nevojës të gjithë stafin administrativ.
- V. Në të gjitha rastet kur është e mundur dhe e lejuar me ligj, të punësuarit e sistemit gjyqësor aktivitetet dhe punën e tyre të realizojnë nga vendet e tyre të banimit, përmes formave të ndryshme të komunikimit elektronik.
- VI. Njëri prind i cili duhet të kujdeset për fëmijën e vet, si dhe zyrtarët me sëmundje kronike mund të lirohen nga puna sipas kërkesës me shkrim të parashtruar tek mbikëqyrësi.
- VII. Masat e theksuara në këtë vendim do të vlejnë deri në një vendim të ri të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi me datë 08 maj 2020.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Të gjitha Gjykatave të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Arkivit.

Skender COÇAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

